

KRONIKË

Policia gjen narkotik, armë zjarri dhe municion gjatë një bastisjeje në Leposaviq



Policia e Kosovës gjatë një bastisje në fshatin Zamenicë të Leposaviqit ka gjetur narkotikë, armë zjarri dhe municion.

Bastisja njoftohet se ka ndodhur të hënën pas pranimit të informacioneve se një i dyshuar ka në posedim substanca narkotike.

Sipas njoftimit, janë sekuestruar gjashtë qese me sasi të substancës së dyshuar të llojit marihuanë me peshë rreth 2600 gram, një pushkë gjuetie dy tytëshe me 26 fishekë, katër karikatorë të armës së gjatë AK-47 me gjithsej 23 fishekë dhe një radiolidhje.

“Në lidhje me rastin njësia e forenzikës ka bërë fotografimin dhe sekuestrimin e provave, po ashtu është njoftuar edhe prokurori kompetent ku me udhëzim të tij janë iniciuar rastet ‘Blerja, posedimi, shitja dhe shpërndarja e paautorizuar narkotikëve substancave psikotrope apo analoge’ dhe ‘Mbajtje në pronësi, posedimi i pa autorizuar i armës’. Lidhur me rastin personi i dyshuar nuk është hasur në shtëpi dhe i njëjti ndodhet në kërkim policor, derisa rasti është duke u trajtuar nga njësitë relevante policore sipas kompetencës”, thuhet në njoftim.

#BASTISJE #LEPOSAVIQ

13 maj 2024 18:55

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

Futboll.

Mediumi rumun: Kosovarët kanë impresionuar në rumani

Botë.

Protestuesit gjeorgjianë përpiqen t'i thyejnë barrierat te Parlamenti pas miratimit të ligjit kontrovers

Futboll.

Rrahmani prej lojtarëve të paprekshëm te Napoli

Arbëri.

“Operacioni policor në veri”, Sveçla e drejtori i Policisë në konferencë të jashtëzakonshme

Arbëri.

Porfirije: Herët a vonë dyert e Patrikanës së Pejës do të hapen

Arbëri.

LDK-ja mbledhet për “zgjedhjet e ardhshme”